FEMZI BRAHA
«PËR POPULL E ATDHE» LIBRI QË NDËRTON SHTËPI
* * *
NGA PËRURIMI I LIBRIT «PËR POPULL E ATDHE» PJESA E DYTË APO LIBRI QË NDËRTON SHTËPI I AUTORIT FEMZI BRAHA NË VINDISCH - AG - ZVICËR MË 15. 12. 2013



Përgatitur nga Abas Fejzullahi

Më 15 Dimror (Dhjetror) 2013 në Vindisch Kantoni Aargau në Zvicër, u përurua libri i autorit Femzi Braha me titull: »**PËR POPULL E ATDHE** «pjesa e dytë, nënë përkujdesjen e Ministrisë së Mërgatës së Republikës së Kosovës, si donator medial RTK, përcolli rrjedhën e programit organizuar nga Këshilli Organizativ, i përbërë nga Abas Fejzullahi, Shukrije Ramadani, Hamzë Morina dhe autori i librit Femzi Braha. Përurimin e nderoi pjesëmarrja e Profesorit Zvicëran **Dr.Dr.Basil Schader**, përfaqësuesi i ambasadës së Kosovës në Zvicër zv.ambasadori Z.Mustafë Xhemajli, përfaqësuesi i bashkësisë fetare për Misionin Katolik për kantonin Argau z. Mirash Hajdaraj, Kryetari i LAPSH »Naim Frashër » për Zvicër Z.Nexhat Maloku dhe miqë e dashamirë të librit dhe autorit, si dhe nxënësit e shkollës Shqipe të kantonit Aargau me recitimet e tyre përgatitur nga mësuesja Eshtrefe Nuhiu dhe Alije Mujaj.

Dy pjesët e librit të autorit Femzi Braha dhe pamje e pjesëmarrësve nga një pjesë e sallës.

Z.Hamzë Morina, lexoj jetëshkrimin e autorit Femzi Braha. Ndërsa vështrimin e shkurtër për librin e lexoj Abas Fejzullahi të titulluar sipas projektit: **»LIBRI QË NDËRTON SHTËPI».**

Z. Shukrije Ramadani, në fjalën përshëndetëse në emrin e Ministrisë së Mërgatës së Republikës së Kosovës, në përkujdesin e së cilës bëhej edhe përurimi i librit, në mes tjerash shprehu urimet më të mira e të përzemërta, drejtuar autorit për librin në veçanti dhe veprimtarin krijuese të tij në përgjithësi. Mes tjerash foli edhe për veprimtarin bamirëse të mërgimtarëve për atdheun në të gjitha periudhat, kur ka qenë nevoja për ndihmë.

Prof.Dr.Dr.Basil Schader, miku i autorit dhe i shqiptarëve si dhe i LAPSH »Naim Frashëri » në Zvicër, përgëzoj autorin **Femzi Braha** për librin në fjalë dhe tha se ishte një befasi e këndshme pjesëmarrja e tij sot këtu, sepse me autorin ka pasur bashkëpunim të gjatë dhe e gëzon fakti se sot po përurohet ky libër i tij i veçantë dhe shumë interesant sipas projektit: **Libri që ndërton shtëpi**. Ai, bëri një krahasim se Shqiptarët në Zvicër po krijojnë dhe tregojnë aftësit e tyre krijuese në shumë drejtime dhe për bashkim, po edhe në drejtimin e bamirësisë. Ai, mes tjerash theksoj se po në fillim të këtij muaji në Bern gazetari Rexhep Rifati, bëri përurimin e librit të tij, Mongrafi për veprimtarët dhe veprimtarit e shqiptarëve në bashkëpunim me Zvicëranët në Zvicër në të gjitha drejtimet. Sot, kam kënaqësinë t`i uroi sukses e punë të mbarë krijuese mikut tim Femziut dhe e përgëzoi për librin shumë shumë interesant që e ka publikuar e ka të bëj me bamirësinë.
Autorin e uruan dhe e përgëzuan edhe zv. Ambasadori z.Mustafë Xhemajli, kryetari LAPSH“ Naim Frashëri“ për Zvicër z. Nexhat Maloku, përfaqësuesi i Misionit Katolik shqiptarë për Kantonin Aargau z. Mirash Hajdaraj, ndërsa z.Fetah Sheholli lexoj një punim kushtuar autorit dhe librit që përurohej.
Në vazhdim pati fjalë të mira edhe urime nga pjesëmarrësit.

Z.Femzi Braha autor i librit të përuruar, përshëndeti ngrohtësisht dhe i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe folësit për urimete dhe njëherit ju përgjegj pyetjeve të parashtruara nga pjesëmarrësit në tubim. Premtoi se, librin e tretë vitin e ardhshëm do ta përurojmë s`bashku me ndërtimin e një shtëpie për një familje skamnore, me përkrahjen që do ma jepni, si deri më tani.

Gjatë përurimit programin e freskuan melodit e luajtura me çifteli dhe recitimet e nxënësve të mësimit plotësuses shqip, përgatitur nga LAPSH “Naim Frashëri“ në kantonin Aargau me mësuesen Eshtrefe Nuiu dhe Alije Mujaj.

Në foto nga e majta në të djathtë, dy nxënëset gjatë recitimeve, autori i librit Femzi Braha dhe Këshilli Organizativ: Abas Fejzullahi, Shukrije Ramadani dhe Hamzë Morina.

Z.Shukrije Ramadani, përfaqësuese e Ministrisë së Mërgatës të Republikës së Kosovës uron autorin për librin dhe iden e tij të realizuar: Libri që ndërton shtëpi, ulur pranë autori Femzi Braha, në mes Abas Fejzullahi dhe Hamzë Morina - Këshilli Organizativ i përurimit të librit „PËR POPULL E ATDHE“ Pjesa e dytë.

Profesori.Dr.Dr.Basil Schader, gjatë fjalës së tij përgëzon autorin e librit Femzi Braha për librin me përmbajtje dhe rëndësi të veçantë sipas projektit LIBRI QË NDËRTON SHTËPI, me të dhëna për jetëshkrimin e bamirësve, si dokumentar për realizimin praktik të ndërtimit të shtëpisë për familje skamnore në Kosovë.

JETËSHKRIMI I AUTORIT

Femzi Braha

Mësuesi dhe shkrimtari Femzi Braha u lind më 1962-07-19 në fshatin Skromë, Bashkia e Vushtrrisë. Shkollën fillore e kreu në Vushtrri, ndërsa Gjimnazin, Drejtimin Kulturologji, e përfundoi në Zveçan të Mitrovicës. Më 1985 i përfundon studimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Universitetin e Kosovës në Prishtinë.

Familja Braha është një familje arsimdashëse. Babai i tij Sokoli, ka qenë mësues i parë i fshatit, ndërsa tani veteran i nderuar i arsimit. Pas diplomimit Femziu ushtroi profesionin e mësuesit në vendlindje. Për arsye ekonomike dhe politike, në vitin 1987 u detyrua të emigrojë në Zvicër. Aktivitetin atdhetar e vazhdoi edhe në mërgim, ku tërsisht iu përkushtua arsimimit të fëmijëve shqiptarë në gurbet. Në vitin 1991 hapi shkollën e parë shqipe të mësimit plotësues në Sion të Kantonit Valis, ku punoj dy vjet bashkë me bashkëshortën e tij mësuesen Vjollca Aliçkaj-Braha nga Irzniqi i Deçanit. Që nga viti 1991 është anëtar i Lidhjes së Arsimtarëve dhe Prindërve Shqiptarë "Naim Frashëri" në Zvicër. Po ashtu Femziu është anëtar i Lidhjes së Arsimtarëve Zviceranë LCH.

Në vitin 1994, krahas punës si mësues në Kantonin e Argaut së bashku me Vjollcën, hartuan fletoren e punës **"SHPRESAT TONA",** e cila u shtyp në Stamboll. Kjo fletore pune atë kohë ishte libri i parë, që u botua për nevojat e nxënësve fillestarë për mësimin e alfabetit shqip në mërgim, që në fakt ishte një Abetare. Më 1994 po ashtu hartoi edhe botoi revistën për nxënësit shqiptarë **" SHQIPONJAT"** në Argau, që u dedikohej nxënësve shqiptarë në Zvicër. Më 1996, s`bashku me prof. Dr. Basil Schader, është bashkautor i librit pedagogjik me

përmbledhje të materialeve shkollore me udhëzime didaktike, i titulluar **"SHQIP",** ky libër në vitin 1997 u vlerësua si libri më i mirë pedagogjik i vitit dhe mori çmimin e parë nga Fondacioni **"Peter Hans Frey"** në Zvicër.

Gjatë luftës së Kosovës ka pasur klubin e tij **"ODA"** në Baden të kantonit argau, ku janë zhvilluar shmë aktivitete dhe veprimtari atdhetare në përkrahjen e luftës së drejtë të popullit shqiptar për çlirim. Po ashtu ishte nisimtar dhe bashkëthemelues i shoqatës humanitare **"Ruzhsi Hyseni"** në Baden të Zvicrës, e themeluar nga mërgimtarët Vushtrrias me banim në Zvicër. Në vitin 2001 botoi në gjermanisht librin për fëmijë **"Kutia e çudirave",**Cyrih. Për dy vite 2001/2002 ishte redaktor i radios shqipe **"Zëri i mërgimtarëve",** pranë valëve të radiios Kanali K, në Arau. Në vitin 2004 botoi librin shqip-gjermanisht **"BESNIKU QENI GUXIMTAR"** në Tiranë. Libri pjesa e parë **"PËR POPULL E ATDHE"**,i botuar në vitin 2012 në Prishtinë, me rastin e 100 – vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Libri pjesa e dytë **"PËR POPULL E ATDHE"** i botuar vitin 2013 në Prishtinë, që është një dhuratë për mërgimtarët në Zvicër, në të cilin paraqitet shpirti njerëzor i bamirësisë dhe përkrahja e këtyre mërgimtarëve që kanë dhënë gjatë viteve dhe japin edhe sot për popull e atdhe. Kjo është pjesa e dytë e këtij libri, e cila sheh driten e botimit me ndihmat e mërgimtarëve përmes veprimtarive te tyre vetanake private të profesioneve të ndryshme që ushtrojnë e punojnë në Zvicër(si afaristë).

Autori, me mjetet që ka marrë nga këta burra e gra, veç botimit të librit, në emër të të gjithë atyre që janë pjesë e parë të librit, ndërtoi një shtëpi komplet deri në çelësa për një familje minatori dhe ish-ushtar i Ushtrisë **ç**lirimtare të Kosovës në Shalë të Bajgorës, në fshatin Bare. Me pjesën e dytë të librit poashtu në emër të të gjithë atyre që janë pjesë e dytë e librit, ndërtoi një shtëpi komplet deri në çelësa një ish-ushtari të Ushtrisë **ç**lirimtare të Kosovës, në fshatin Palaj të Bashkisë së Obiliqit. Ky libër tashmë projekt do të vazhdojë me pjesën e tretë me iden e autorit **LIBRI QË NDËRTON SHTËPI FAMILJEVE SKAMNORE NË ATDHE**. Shkrimtari Femzi Braha për punën e tij në vazhdimsi në shumë drejtime si në arsim dhe në bamirësi është vlerësuar dhe nderuar me Mirënjohje : Nga LAPSH" Naim Frashëri" në Zvicër me rastin e 100-vjetrit të Shtetit Shqiptarë më 2012, dhe nga Bashkia e Obiliqit për veprimtarin bamirëse poashtu me Mirënjohje në vitin 2013.

LAPSH Lidhja e Arsimtarëve dhe Prindërve Shqiptarë "Naim Frashëri" në Zvicër
ALEV Albanischer Lehrer- und Elternverband "Naim Frashëri" in der Schweiz
LEPA Ligue des Enseignants et des Parents Albanais "Naim Frashëri" en Suisse
LIGA Lega degli Insegnanti e di e Genitori Albanesi "Naim Frashëri" in Svizzera

LIDHJA E ARSIMTARËVE DHE PRINDËRVE SHQIPTARË
" NAIM FERASHËRI" NË ZVICËR

MIRËNJOHJE

Me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë
Veprimtarit të Shkollës Shqipe në Zvicër

FEMZI BRAHA

Për punën e suksesshme shumëvjeçare në organizimin dhe mbarëvajtjen e mësimit plotësues në gjuhën shqipe në Kantonin e Aargaut.

Suhr, nëntor 2012

LAPSH "N. Frashëri" në Zvicër

Hamzë Morina - Kryetar

Botimet
SHQIPONJAT
SHQIPONJAT
SHQIPONJAT
SHQIPONJAT
SHQIPONJAT
SHQIPONJAT
SHQIPONJAT
SHQIPONJAT
Shqip!
SHPRESAT TONA
DIE WUNDERSCHACHTEL
BESNIKU, QENI GUXINTAR
BESNIK, DER TAPFERE HUNI

KOMUNA E OBILIQIT
19
46
OBILIQI - OBILIĆ
MIRËNJOHJE
Familjes BRAHA, për kontributin e dhënë në ndertimin e shtepisë
familjes BULLAKU
Tetor 2013
Obiliq
Kryetari i Komunës
z.Mehmet Krasniqi

Një vështrimi i shkurtër, për librin e autorit Femzi Braha "PËR POPULL E ATDHE" apo LIBRI QË NDËRTON SHTËPI !

Nga, Abas Fejzullahi

FNF »Bamirësia është thesari i vetëm, i cili shtohet duke e ndarë me të tjerët»

Thënia e autorit Femzi Braha në fillim të librit **« Jorgani i mërgimtarit është dheu i Atdheut »** është thënie që në kohë dhe hapësirë, përcjell në vazhdimësi jetën e mërgimtarëve, të ballafaquar me përditshmërinë, në lidhshmëri të vazhdueshme me gjendjen, kushtet,

rrethanat dhe fatin e Atdheut, kudo që ata gjinden në mërgim, hija, malli dhe dashuria për Atdhe, janë pjesë e pa shkëputur në jetën e tyre të përditshme.

Autori në parathënien të librit **"PËR POPULL E ATDHE",** qysh në pjesën e parë të tij, të përuruar para një viti, në bashkëbisedim me pjesëmarrësit lidhur me **veprën** dhe projektin : "**LIBRI QË NDËRTON SHTËPI"** mu në këtë vend, Zotëri Adem Pllana, zotëri Famzi Brahës iu drejtua me këtë pyetje :

Mësues, kur do të filloni me pjesën e dytë të librit ?

Autori u përgjigj: Menjëherë, që sonte pas darke, pasi të pushoj pak dhe me mbështetjen dhe përkrahjen e juaj që ma keni dhënë e që do të ma jepni edhe në të ardhmen.

Ai, fjalën e dhënë e bëri realitet këtë vit, me pjesën e dytë të librit me të njëjtin titull : **PËR POPULL E ATDHE,** që sot na ka bashkuar këtu, për ta bërë përurimin së bashku, pasi jetësoj ndërtimin e shtëpisë së dytë këtë vit, për një familje tjetër skamnore.

Ndaj unë do të përdor një shprehje të zgjedhur të Sami Frashërit, që përputhet me rastin në fjalë e cila thotë:

(Sami Frashëri) 798:Në çastin e vdekjes së njeriut, zhduken të gjitha; lakmia, dëshira për famë dhe zelli ; vetëm mirësitë i mbeten besnike dhe i`a rrethojnë shtratin.

Autori Femzi Braha në realizimin e veprës **: LIBRI QË NDËRTON SHTËPI,** është një projekt bamirësie, i natyrës së veçantë në drejtimin e bamirësisë, për skamnorët e pa strehë. Këtë veprimtari autori e ka jetësuar në praktik që dy vite me radhë, me përfshirjen në bashkëpunim të mërgimtarëve bamirës, që jetojnë dhe punojnë në Zvicër, të ardhur nga të gjitha trojet e Shqipërisë Natyrale, me të gjitha profesionet që ushtrojnë, përmes punës së tyre që kryejnë me përgjegjësi dhe me nderë në Zvicër.

Autori është një publicistë i natyrës së veçantë, që deri më tani s`është hasur në publicistikën tonë, nga se me punën e tij hulumtuese në drejtimin e bamirësisë, ai nuk kursen kohën, mundin e as shpenzimet, për të hulumtuar dhe zbuluar bamirës anë e këndë Zvicrës, të cilët e përkrahin projektin, **LIBRI QË NDËRTON SHTËPI,** por në të njëjtën kohë autori me një kujdes të veçantë, prej publicisti dhe hulumtuesi, arrin të zbuloj dhe grumbulloj edhe të dhëna të shumta për ndihma tjera, që kanë bërë dhe bëjnë herë pas here, bamirësit nëpër shumë organizata tjera të bamirësisë, që veprojnë në Zvicër.

Mërgimtarët kanë dhënë e dhuruar ndihma për skamnorët. jo vetëm në Atdheun e tyre por edhe për skamnorët në Afrikë, dhe kontinente tjera kur është paraqitur nevoja dhe drejtuar kërkesa përmes organizatave të ndryshme bamirës si: SHH »Nënë Tereza », SHH« Minatori», SHH »Medvegja », UNICEF-i, Caritasi, « SOS »,Krebs Liga » SHH »Haki Povataj », SHH »Salih çekaj », SHH »Nëna Shqiptare », SHH »Shpresa », SHH »Drejtësia », « Mjekët pa kufij » si dhe shumë Shoqata kulturo-artistike, klube sportive, por edhe bursa për student.

Mërgimtarët kanë ndihmuar LAPSH »Naim Frashëri » në Zvicër, për ruajtjen e gjuhës së origjinës përmes mësimit plotësues, ku edhe vet autori, jo vetëm se ka dhënë ndihmën profesionale si mësues por edhe ka hartuar e publikuar edhe tekste shkollore për mësimin plotësues në bashkëpunim me mikun e madh të Shkollës Shqipe dhe të shqiptarëve të nderuarin z. Dr. Dr. Basil Schader.

Famziu në librin e tij, **PËR POPULL E ATDHE** në pjesën e parë ka përfshi jetëshkrimin e 130 bamirësve ku 35 prej tyre kanë ndihmuar SHH »Familja ndihmon familjen » ndërsa në pjesën e dytë të librit janë përfshirë 172 bamirës, ku 32 prej tyre e kanë ndihmuar **SHH »FNF »**

Ai me një kujdes të veçantë bamirësit i radhit në dy pjesët e librit, me jetëshkrimin e tyre, për ndihmat që kanë dhënë, e që në mesin e tyre ka edhe ushtarë të lirisë, që ishin në luftë kur nevoja e atdheut e kërkoi, të cilët pas lufte u kthyen përsëri në mërgim dhe vazhdojnë të jetojnë dhe punojnë në Zvicër, ku vazhdimisht ndihmojnë dhe janë bërë pjesë e pandashme e projektit, Libri që ndërton shtëpi, si dhe ndihma tjera këtu në mërgatë, për popull dhe Atdhe.

Në vijim, ja edhe një thënie (e **Sami Frashërit 741)** lidhur me skamjen e popullit dhe pasurin e pushtetarëve, që edhe në ditët e sotme është një realitet ekzistues dhe u bie përshtati kjo thënie:

Sa më të mëdha të jenë varfëria dhe mjerimi i popullit, aq më të mëdha janë pasuria dhe madhështia e pushtetarëve.

Kurse në vend të përfundimit do të veçoja :

Autori Femzi Braha, përveç veprimtarisë në fushën e bamirësisë, ai me botimin e dy librave, "**PËR POPULL E ATDHE",** kushtuar bamirësisë dhe bamirësve mërgimtar në Zvicër, është shëndërruar në hulumtues dhe zbulues tani më me përvojë të bamirësve, të cilët edhe po e përkrahin praktikisht në projektin e tij të veçantë, **LIBRI QË NDËRTON SHTËPI,** duke lënë gjurmë me të dhëna burimore për gjeneratat e ardhme që kanë dëshirë të hulumtojnë, thellojnë dhe zhvillojnë njohurit e tyre në drejtimin e bamirësisë. Ndaj, shpresojmë dhe jemi të bindur se Femziu do na tuboj edhe vitin e ardhshëm me pjesën e tretë, të librit dhe shtëpinë e tretë të ndërtuar sipas projektit: **LIBRI QË NDËRTON SHTËPI.** Urime dhe sukses Femziut në punën e tij krijuese, bamirëse dhe kombëtare dhe një falënderim të veçantë të gjithë atyre që kanë përkrahur dhe përkrahin autorin, në këtë drejtim sa fisnik, kombëtar e njerëzor. Ju faleminderit për durimin dhe vëmendjen.

A.F
2013-12-15
Vindisch AG –CH

FOTO ALBUMI NGA PËRURIMI I LIBRIT TË AUTORIT FEMZI BRAHA “PËR POPULL E ATDHE” PJESA E DYTË

Autroi i librit Femzi Braha, me rastin e përgjigjeve në pyetjet e parashtruara nga pjesëmarrësit.

Pamje nga pjesëmarrësit në sallë para fillimit të përurimit të librit, në foto me kapelë dhe mustaqe babai i autorit , mësues veteran z.Sokol Braha.

Z.Shukrije Ramadani, përfaqësuese e Ministrisë së Mërgatës të Republikës së Kosovës uron autorin për librin dhe iden e tij të realizuar: Libri që ndërton shtëpi, ulur pranë autori Femzi Braha në mes Abas Fejzullahi dhe Hamzë Morina - Këshilli Organizativ i përurimit të librit „PËR POPULL E ATDHE“ Pjesa e dytë.

Pamje nga pjesëmarrësit: majtas Behide Hasanaj, me syze - bamirëse e njohur, ndërsa pranë çantës me rroba e flok të bardha Vlora Avdyli.

Pamje nga pjesëmarrësit: në foto me shallë rreth qafe Z.Adem Osmani përballë bashkëshortja e tij Zonja Florije Osmani, pjesë e projektit "Libri që ndërtin shtëpi" dhe donator jo vetëm i këtij projekti e libri por edhe i shumë drejtimeve tjera bamirëse, në veçanti ndihmon vazhdimisht LAPSH "Naim Frashëri" në Zvicër etj.

Profesor Dr.Basil Schader flet lidhur me projektin: Libri që ndërton shtëpi si ide e autorit të Librit „Për popull e atdhe„ dy pjesë, ku përmes bashkëatdhetarëve në mërgim që kanë veprimtarit e tyre të ndryshme, kanë qenë pjesë e këtij projekti të veçantë për ndërtimin e shtëpive për skamnorët në atdhe, andaj me dy pjesët e librit përfshinë jetëshkrimin e mbi 300 mërgimtarëve që kanë ndihmuar për të ndërtuar dy shtëpi për dy familje skamnore në Kosovë. Dr. Basil Shadri ishte i befasuar me natyrën e këtij projekti, të veçantë dhe jetësimin e tij, dhe i kënaqur për veprimtarin e autorit me të cilin ka hartuar bashkërisht edhe tekstet e para për mësimin plotësues shqip në Zvicër.

Pamje nga pjesëmarrësit në sallë që përcjellnin rrjedhat e programit lidhur me përurimin e librit :„PËR POPULL E ATDHE“ PJESËN E DYTË.

Soklo Braha (baba i autorit Femzi B) veteran i arsimit me kapelë e mustaqe dhe Abas Fejzuullahi

Z.Gani Qarri me kapel dhe gazetari veteran Rexhep Rifati.

Nxënëset e shkollës shqipe të mësimit plotësues nga Vindischi, gjatë recitimit të disa poezive. I pari me kravatë, autori i librit Femzi Braha „PËR POPULL E ATDHE“, pranë tij Abas Fejzullahi, në vazhdim Z.Shukrije Ramadani dhe në fund Z.Hamzë Morina në Këshillin Organizativ për përurimin e librit në fjalë.

Mësuesja Alije Mujaj, lajmëron pjesëmarrësit për recitimet që do të paraqiten nga nxënësit e Shkollës shqipe, që vijojnë mësimin plotësues në Vindisch dhe Shpreitenbah kantoni i Aargaut.

Pamje nga programi i shfaqur herë pas here me pika artistike nga nxënësit e SHSHMP.

Pamje nga recitimi i disa poezive nga nxënësit.

Z.Nexhat Maloku përfaqësues i LAPSH »Naim Frashëri» në Zvicër në cilësinë e kryetarit, përgëzon autorin e librit Z.Femzi Brahën për puën e tij jo vetëm si koleg në fushën e arsimit, por edhe si krijues e hartues i teksteve fillimisht për SHSHMP dhe tani me publicistikë me librat në dy pjesë « PËR POPULL E ATDHE», në bashkëpunim dhe përkrahjen e mërgimtarëve këtu në Zvicër të cilët kanë krijuar veprimtari të ndryshme, kanë ndihmuar botimin e librit përmes ides : LIBRI QË NDËRTON SHTËPI. Dhe në këtë drejtim Femziu ka realizuar praktikisht edhe botimin e librave edhe ndërtimin e dy shtëpive për familjet skamnore në Kosovë. Për këtë uroj dhe përgëzoj autorin me fjalët më të mira.

© Pashtriku.org, dhjetor '2013